



---

**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së,  
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +,  
në Universitetin Politeknik të Torinos, Itali**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës në Universitetin Politeknik të Torinos, Itali.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës.

**Kohëzgjatja e bursave:**

- 1 semestër – semestri i II, viti akademik 2021-2022

**Fusha e studimit:**

Arkitekturë

Numri total i studentëve: 4

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*



**Key Action 1**  
**- Mobility for learners and staff -**

---

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze dhe/ose në gjuhën italiane, ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Nëse do të përzgjidhen lëndë që zhvillohen në të dyja gjuhët, studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për të dyja këto gjuhë duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

*\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Politeknik të Torinos lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*

*Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

*Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement", ju lutemi, klikoni te link-u:*

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en)

*Për të parë listën e lëndëve të ofruara nga POLITIO, ju lutemi klikoni te link-u:*

[Portale della Didattica \(polito.it\)](http://portale.didattica.polito.it)

**Afati për aplikim për studentët: deri më 1 Nëntor 2021**

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT. Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në e-mail: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al), [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)